

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 266, datë 20.6.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 20, DATË 1.9.2023, “PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE PROCEDURËS SË PUNËSIMIT ME PRIORITET TË MJEKËVE QË PËRFITOJNË TRAJTIM TË VEÇANTË NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6, të ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 20, datë 1.9. 2023, “Për përcaktimin e mënyrës dhe procedurës së punësimit me prioritet të mjekëve që përfitojnë trajtim të veçantë në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 2, togfjalëshi “pajisjen me lejen e ushtrimit të profesionit të mjekut, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi” zëvendësohet me togfjalëshin “pajisjen me licencën e ushtrimit të profesionit të mjekut, brenda 10 ditë pune nga përfundimi me sukses i provimit të shtetit”;

b) shkronja “b”, e pikës 2, të nenit 2, ndryshon si vijon:

“b) organizon procedurën për njoftimin për vendet e lira të punës dhe punësimin e këtyre mjekëve, sipas nevojave të sistemit shëndetësor si vijon:

i. publikon vendet vakante për mjek të përgjithshëm në faqen *web* të ministrisë;

ii. thërret mjekët për përzgjedhjen e vendit vakant, sipas renditjes me pikë, mbi bazën e notës mesatare të përfundimit të studimeve;

c) shkronja “c”, e pikës 2, të nenit 2, ndryshon si vijon:

“c) nxjerr aktin e emërimit të mjekut, dërgon kopje të diplomës me suplementin, si dhe licenca për ushtrimin e profesionit, të njehsuar, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në institucionin shëndetësor ku punësohet, për t’u administruar në dosjen personale të mjekut, sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

d) Në nenin 3, togfjalëshi “vendlindjen/vendbanimin”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Albana Koçiu

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Ogerta Manastirliu